



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTIKORRUPSION DHE
DINJITET-ÇOHU!

RAPORT MONITORUES Nr. 2

Shqyrtimi i Lëndëve të Korrupsionit nga Organet e Drejtësisë 2008-2011

JANAR 2013

Shehi Nënë Tereza, Rruga "2 Korriku" Nr. 2/2, Prishtinë

organizatacohu@yahoo.com

www.cohu.org

038 248 506

Ky botim është realizuar me përkrahjen e **Civil Rights Defenders-** (CRD)
Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Organizatës ÇOHU!**.

Përgatitur nga: Arton Demhasaj

Copyright © 2013 ÇOHU!. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: organizatacohu@yahoo.com, office@cohu.org, arton.demhasaj@cohu.org, lorik.bajrami@cohu.org apo +381 38 248 506.

Botuar nga:

Organizata për Demokraci, Anti-
korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU!
Rruga: 2 Korriku; Nr.4; Hy.4
Prishtinë, Kosovë
Tel / +381 (0)38 2248 506
www.cohu.org

PËRMBAJTJA:

1. HYRJA:	1
2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME:	2
2.1. Prokuroritë Publike.....	2
2.2. Gjykatat Komunale dhe të Qarkut.....	4
3. TË GJETURAT KRYESORE	4
3.1. Prokuroritë Publike të Kosovës 2008-2011.....	4
3.2. Gjykata Komunale dhe të Qarkut të Kosovës 2008 dhe 2011.....	9
4. PËRFUNDIMI	14

METODOLOGJIA:

Ky raport monitorues, është rezultat i hulumtimit kuantitativ dhe kualitativ, i cili për bazë ka burime primare dhe sekondare. Sa i përket burimeve primare, janë përdorur metodat e intervistimit direkt të akterëve relevant të fushës së gjyqësorit (gjykata komunale, gjykata të qarkut, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe Prokuroria e Shtetit).

Po ashtu, për nevoja të këtij raporti, janë konsultuar edhe Ligjet penale (Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës), si dhe aktet tjera juridike. Për burimet sekondare, janë marrë për bazë edhe analiza tjera politikash, hulumtime të opinionit si dhe reagime që fokusohen në fushën e gjyqësorit, me theks të veçantë të fushës kundër korrupsionit. Për më shumë, janë konsultuar edhe burime të tjera të informacionit si mediet elektronike dhe të shkruara.

Bazë e këtij raport monitorues janë të dhënat statistikore mbi trendin e shqyrtimit të rasteve kundër korrupsionit (veprat penale kundër detyrës zyrtare) nga Prokuroritë publike dhe Gjykatat komunale dhe të qarkut të Kosovës. Raporti ka për bazë periudhën 2008-2011.

Në këtë raport përdoret edhe metoda krahasuese me qëllim të krahasimit të shqyrtimit të lëndëve të korrupsionit ndër vite, por edhe krahasimit me vepra tjera penale si ato kundër ekonomisë.

1. HYRJE -

Sistemi i drejtësisë në vazhdimësi ka qenë në fokus të kritikave dhe akuzave nga më të rëndat për sa i përket mungesës së rolit të tij në luftimin e korrupsionit. Në realitet, prokuroritë dhe gjykatat, përgjatë tranzicionit të pas luftës, kanë dështuar që të ofrojnë bazën funksionale të sistemit të drejtësisë. Veçanërisht, sistemi i drejtësisë ka dështuar plotësisht që të sigurojë dhe vë në jetë integritetin e duhur për t'u përballur me kërkesat në rritje për sa i përket hetimit, ndjekjes dhe gjyqimit të lëndëve të korrupsionit.

Korrupsioni, tashmë edhe brenda diskursit qeveritar, përbën veçorinë kryesore dhe tendencën për identifikimin e institucioneve të Republikës së Kosovës me sundimin e ligjit. Përkundër kësaj, vendosja e kësaj lufte në prioritet të institucioneve të Republikës së Kosovës është kristalizuar dhe ka mbetur vetëm në dimensionin retorik dhe atë formal të aprovimit të kuadrit të dobët ligjor dhe institucional kundër korrupsionit. Deri më tani, aprovimi i ligjeve dhe themelimi i institucioneve kundër korrupsionit, më shumë ka shërbyer si zëvendësim i rezultateve konkrete, dhe kështu iniciativë kryekëput estetike.

Në mënyrë krejtësisht ironike, penguesit kryesor të reformimit të plotë të sistemit të drejtësisë janë pikërisht ata që me fuqinë e ligjit janë të veshur për të krijuar hapësirë për funksionimin e mirëfilltë të tij. Në këto dymbëdhjetë vjet funksionim të sistemi të drejtësisë në kushte të lira, buxheti që i është ndarë kësaj dege të pushteti, deri në vitet 2011-12, asnjëherë nuk ka kaluar 1% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës¹. Kjo ka bërë që dega e pushtetit të tretë, në vazhdimësi të jetë me staf të mangët dhe resurse të pakta për të plotësuar obligimet ligjore. Për më shumë, ndërhyrjet e nivelit politik, direkt apo indirekte që i janë bërë sistemit të drejtësisë kanë bërë që prokuroritë dhe gjykatat të mos kenë hapësirën e duhur dhe mundësinë për të vepruar.

Duhet kujtuar se më 2008, kryeministri i tashëm i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi pat deklaruar se sistemi i drejtësisë është ndër institucionet më të korruptuara në Kosovë. Po ashtu, edhe drejtues të Agjencioneve të pavarura, si drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, (AKK) ka drejtuar gishtin dhe ka akuzuar sistemin e drejtësisë, veçanërisht prokuroritë, për mosfunksionim edhe përkundër faktit se vlerësimi për (mos) funksionim të gjyqësorit më së paku është përgjegjësi ligjore e këtij Agjencioni. Këto lloj deklaramesh të drejtuesit të Qeverisë dhe drejtorit të AKK-së, dëshmojnë për

¹ **Instituti i Kosovës për Drejtësi (IDK)** – “Pavarësia e Gjyqësorit në Kosovë – Analizë e pavarësisë financiare, institucionale dhe individuale”, Prishtinë, Nëntor 2012.

natyrën e cenueshme të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe lehtësinë e ndërhyrjes indirekte në këto organe.

Por, edhe vet sistemi i drejtësisë, veçanërisht gjykatat, brenda vetë domenit të tyre kanë qenë të prekura nga korrupsioni. Vetë drejtuesi i Task Forcës kundër Korrupsionit, Nazmi Mustafi është duke u gjykuar për korrupsion dhe gjyqtarë të nivelit komunal por edhe të qarkut, janë dënuar për vepra të korrupsionit². Për më tepër, një raport i më hershme i Organizatës ÇOHU! tregon se një numër shumë i madh, mbi 8000 mijë lëndë penale janë parashkruar përgjatë viteve 2000-2012³. Në një hulumtim tjetër paralel të Organizatës ÇOHU! tregohet se përgjatë viteve 2000-2012, janë parashkruar rreth 31 vepra të korrupsionit në gjykatat e Kosovës. Po kështu, një hulumtim tjetër tregon se si gjyqtarët flasin për tendencën e kolegëve të tyre gjyqtarë për t'u korruptuar⁴.

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME:

Raporti monitorues “Shqyrtimi i Veprave të Korrupsionit nga Organet e Drejtësisë”, paraqet trendin e shqyrtimit dhe strukturën e veprave të korrupsionit nga prokuroritë dhe gjykatat e Kosovës përgjatë viteve 2008-2011. Ky raport monitorues nxjerrë në pah tri veçori mjaft shqetësuese mbi trendin e shqyrtimit dhe strukturën e veprave të korrupsionit nga organet e drejtësisë.

E para, raporti tregon se prokuroritë si dhe gjykatat përgjatë viteve 2008-2011, kanë arritur që t'i shqyrtojnë rreth **46 %** (prokuroritë), dhe më pak se **30 %** (gjykatat) e të gjitha lëndëve kundër korrupsionit që kanë qenë në punë. E dyta, për sa i përket natyrës së dënimeve, raporti tregon që si tek prokuroritë, por edhe te gjykatat, vendimet që kanë përfunduar me aktakuzë, ose aktgjykime dënuese, janë po ashtu shumë të ulëta. E treta, nga ky raport vërehet se gjykatat shqyrtojnë si në përqindje po ashtu edhe në numër, nivel më të ulët të lëndëve të korrupsionit për dallim nga prokuroritë publike. Nga **46 %** e totalit të lëndëve të shqyrtuara nga prokuroritë del se vetëm **11.7 %** e tyre kanë përfunduar me aktakuzë, si dhe **33.8 %** e tyre janë hedhur poshtë ose kanë përfunduar me urdhër ndëshkimor ose janë zgjidhur në mënyrë tjetër. Përderisa tek gjykatat vërejmë po ashtu trend të njëjtë të karakterit të gjykimëve ku nga **29.7 %** e

² **Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese** – Preportri; Besa Kalaja, “Lufta e Eulexit me Televizor”, Prishtinë 04.10.2012. E qasur më 21.01.2013.

³ **Organizata ÇOHU!** – “Parashkrimi i Ndjekjeve Penale dhe Ekzekutimeve Penale”, Janar 2012.
http://ëëë.cohu.org/repository/docs/Statuary_Limitation-Report-Shqip_837675.pdf

⁴ **Organizata ÇOHU!** – “Integrimi Evropian, Gjyqësori dhe Lufta kundër Korrupsionit; Gusht 2009.
http://ëëë.cohu.org/repository/docs/Integrimi_Evropian_Gjyqesori_dhe_Lufta_kunder_Korrupsionit_102_59.pdf

rasteve, që janë zgjidhur, **18.3 %** e tyre kanë përfunduar me aktgjykime dënuese, ku prej tyre **8.6 %** kanë përfunduar me gjobë.

2.1. Prokuroritë Publike:

1. Nga viti 2008 deri më 2011, del që prokuroritë publike në Kosovë **kanë pasur në punë 4024 raste** që kanë të bëjnë me vepra penale kundër detyrës zyrtare, të klasifikuara si vepra të korrupsionit. Nga kjo shifër del se **janë zgjidhur 1836 raste**, përderisa **kanë mbetur pa u zgjidhur 2188 raste** kundër korrupsionit.
2. Në përgjithësi, del se vetëm **46 % e lëndëve kundër detyrës zyrtare** janë shqyrtuar nga prokuroritë në këto katër vite, ndërsa **lëndët kundër ekonomisë janë shqyrtuar me 63 %**. Përderisa, mesatarja e shqyrtimit të lëndëve penale në përgjithësi është 75.2 %.
3. Po të shikojmë tabelën e vendimeve të rasteve të shqyrtuara nga prokuroritë publike del se nga gjithsej **46 % (1836)**, e lëndëve të shqyrtuara, vetëm **11.7 % (473)** e tyre kanë përfunduar me aktakuzë dhe **33.8 %** e tyre janë hedhur poshtë ose kanë përfunduar me urdhër ndëshkimore ose janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

2.2. Gjykatat Komunale dhe të Qarkut:

1. Në gjykatat komunale dhe të qarkut gjatë viteve 2008-2011, në punë kanë qenë **1548 raste** të dyshuara për korrupsion, nga të cilat 460 (**29.7 %**), raste janë zgjidhur, ndërsa kanë mbetur pa u zgjidhur edhe **1088 raste** të dyshuara për korrupsion (vepër penale kundër detyrës zyrtare). Nga gjithsej **460 raste** sa janë zgjidhur nga gjykata në periudhën raportuese, **33 raste** ju përkasin gjyqtarëve të EULEX-it.
2. Nga **29.7 %** e lëndëve të gjykuara nga gjykata komunale dhe të qarkut për vitet 2008-11, vetëm **18.3 %** e tyre kanë përfunduar me aktgjykime dënuese, ku prej tyre **8.6 %** kanë përfunduar me gjobë. Ndërsa **11.3 %** e lëndëve të gjykuara kanë përfunduar me aktgjykim lirues.

Ky raport përgjithësisht jep një pasqyrë të qartë të trendit shqyrtimit të veprave penale kundër detyrës zyrtare dhe i cili tregon se në të dy degët e sistemit të drejtësisë, numri i shqyrtimi të lëndëve kundër korrupsionit është i ulët dhe me karakter të butë të ndëshkimit.

3. TË GJETURAT KRYESORE

3.1. Prokuroritë Publike të Kosovës 2008-2011

Trendi i shqyrtimit të veprave të korrupsionit (veprave penale kundër detyrës zyrtare) në periudhën raportuese 2008-2011, ka qenë i një niveli shumë të ulët edhe me karakter të masave ndëshkuese shumë të buta.

Nëse analizohen të dhënat për punën e prokurorive publike, del se një numër shumë i vogël i rasteve të dyshuar për vepra penale kundër detyrës zyrtare (korrupsionit) janë marrë në shqyrtim nga këto prokurori. Por, edhe në ato raste kur këto vepra janë marrë në shqyrtim, pjesa dërmuese e tyre: **a)** janë hedhur poshtë, **b)** janë pushuar hetimet ose **c)** janë zgjatur pafundësisht hetimet, dhe një pjesë e vogël e rasteve të paraqitura në prokuroritë komunale dhe të qarkut janë vërtetuar dhe për këto raste janë ngritur aktakuzat dhe janë dërguar për procedim të mëtutjeshëm në gjykatat komunale apo të qarkut.

Tabela e më poshtme tregon rastet e paraqitura në prokuroritë komunale dhe të qarkut gjatë viteve 2008-2011, të kapitujve: **a)** XXIX- *veprat penale kundër detyrës zyrtare* dhe **b)** XXII-*veprat penale kundër ekonomisë*, të Kodit Penal të Kosovës. Këto të dhëna të këtyre kapitujve do të përdoren për qëllime krahasuese për të dhënë një pasqyrë më të qartë të trendit të shqyrtimit të këtyre lëndëve nga prokuroritë publike.

<u>Kapitulli XXIX</u> <u>Vepra Penale Kundër Detyrës Zyrtare</u>	VITI 2008	VITI 2009	VITI 2010	VITI 2011	TOTALI
Raste në punë	655	749	1088	1532	4024
Raste të zgjidhura	305	356	390	785	1836
Raste të pazgjidhura	350	393	698	747	2188
<u>Kapitulli XXII</u> <u>Vepra Penale Kundër Ekonomisë</u>					
Raste në punë	-	1009	1130	1303	3442
Raste të zgjidhura	-	784	679	732	2195
Raste të pazgjidhura	-	225	451	571	1247

Tabela 1: Trendi i shqyrtimit të veprave penale: a) XXIX- veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe b) XXII-veprat penale kundër ekonomisë, të Kodit Penal të Kosovës, gjatë viteve 2008-2011.

Në vitin 2008 në prokuroritë publike të Kosovës mungojnë të dhënat për rastet e shqyrtuara që ju përkasin veprave penale kundër ekonomisë. Të dhënat për këtë kapitull të Kodit Penal të Kosovës ka vetëm nga numri i rasteve të paraqitura, e që për vitin 2008 janë paraqitur raste kundër 944 personave.

Lidhur me fletëparaqitjet penale ndaj personave të dyshuar për vepra penale kundër detyrës zyrtare (korrupsionit), nga fletëparaqitjet e 655 personave sa kanë qenë në punë gjatë vitit 2008, prokuroritë publike komunale dhe ato të qarkut kanë shqyrtuar fletëparaqitjet e 305 personave, dhe kanë mbetur pa u shqyrtuar fletëparaqitjet edhe për 350 persona. Në vitin 2009, nga 749 raste sa kanë qenë në punë si raste kundër detyrës zyrtare, vetëm 356 raste janë shqyrtuar dhe 393 kanë mbetur pa u shqyrtuar. Në vitin 2010, nga gjithsej 1088 raste sa kanë qenë në punë, prej tyre vetëm 390 janë shqyrtuar, ndërsa kanë mbetur pa u shqyrtuar edhe 698 raste. Në vitin 2011, nga totali i 1532 rasteve, janë shqyrtuar vetëm 785 raste ndërsa kanë mbetur pa u shqyrtuar edhe 747 raste.

Në total, për vitet 2008 -11, prokuroritë komunale dhe të qarkut kanë shqyrtuar gjithsej 1836, prej të cilave 127 lëndë janë shqyrtuar nga EULEX-i. Nga rastet e shqyrtuara nga EULEX-i, 21 sosh kanë përfunduar me aktakuzë.

Nëse marren dhe llogariten në përgjithësi, del se vetëm **46 % e lëndëve kundër detyrës zyrtare** janë shqyrtuar nga prokuroritë në këto katër vite, ndërsa **lëndët kundër ekonomisë janë shqyrtuar me 63 %**. Ndërsa mesatarja e shqyrtimit të lëndëve penale në përgjithësi është 75.2 %.




Tabela 2: Struktura në përqindje e shqyrtimit të veprave penale: a) XXIX- veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe b) XXII-veprat penale kundër ekonomisë, si dhe mesatarja e shqyrtimit të lëndëve penale në përgjithësi të Kodit Penal të Kosovës, gjatë viteve 2008-2011.

Nga tabela më lartë shihet se ka një tendencë të shqyrtimit më të ulët të rasteve që kanë të bëjnë me korrupsion, në krahasim më përqindjen më të lartë të shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me vepra tjera penale p.sh ato kundër ekonomisë.

VENDIMET	VITI 2008	VITI 2009	VITI 2010	VITI 2011	TOTALI	Përqindja
Dërgimi në kompetencë	58	76	47	184	365	19.8 %
Numri i rasteve që është hedhur kallëzimi penal	58	46	71	119	294	16 %
Pezullimi i hetimit	-	01	13	15	29	1.5 %
Pushimi i hetimit	21	46	48	85	200	10.8 %
Heqja dorë e ndjekjes penale	-	-	2	-	2	0.1 %
Propozimakuza	67	107	71	128	373	20.3 %
Propozimakuza për dhënien e urdhrin ndëshkimor	19	06	21	14	60	3.2 %
Aktakuza e drejtpërdrejt	19	09	8	53	89	4.8 %
Aktakuza pas hetimit	53	60	98	173	384	20.9 %
Kallëzimi penal është zgjidhur në mënyrë tjetër	10	05	11	14	40	2.1 %
TOTALI	305	356	390	785	1836	100 %

Tabela 3: Natyra e vendimet të Prokurorive Komunale dhe atyre të Qarkut për lëndët kundër detyrës zyrtare (korrupsionit) gjatë viteve 2008-2011.

Po të shikojmë tabelën e vendimeve të rasteve të shqyrtuara nga prokuroritë publike, del se nga gjithsej **46 %** (1836), e lëndëve të shqyrtuara, vetëm **11.7 %** (473) e tyre kanë përfunduar me aktakuzë dhe **33.8 %** e tyre janë hedhur poshtë ose kanë përfunduar me urdhër ndëshkimor ose janë zgjidhur në mënyrë tjetër.




Tabela 4: Natyra e vendimet të Prokurorive Komunale dhe atyre të Qarkut për lëndët kundër detyrës zyrtare (korrupsionit) gjatë viteve 2008-2011.

Shkallën e ulët të zgjidhjes së fletëparaqitjeve penale të cilat kanë të bëjnë me veprat penale kundër detyrës zyrtare (korrupsionit), raporti për punën e prokurorive publike, e “arsyeton me faktin se veprat penale kundër detyrës zyrtare (korrupsionit), janë shumë të ndërlikuara, sepse në të shumtën e rasteve këto vepra penale kryhen në **katër sy** çka do të thotë së vështirë mund të sigurohen provat-dëshmitë për kryerjen e këtyre veprave penale”⁵,

⁵ Raporti për punën e prokurorive publike të Republikës së Kosovës për vitin 2008, faqe 35.

Gjithashtu, edhe koordinatoresha e Prokurorisë së shtetit për luftën kundër korrupsionit, Drita Hajdari shkallën e ulët të shqyrtimit të lëndëve me natyrë korruptive e arsyeton me mungesën e prokurorëve të specializuar për fushën përkatëse deri në vitin 2011, dhe me vështirësinë e hetimit dhe të argumentimit të këtyre veprave penale. Ajo shprehet se: “natyra e veprave penale korruptive është specifike dhe vështirë vërtetohet”⁶. Pas kësaj, prokurorja Hajdari shprehet se lëndët që vijnë nga Agjencia Kundër Korrupsionit, sillen të pa argumentuara dhe se është shumë e vështirë të ngritët ndonjë aktakuzë nga informacionet e AKK-së.

Arsyet tjetër për shkallën e ulët të zgjidhshmërisë ose shqyrtimit të rasteve të veprave penale kundër detyrës zyrtare, sipas të njëjtit burim është se, personat të cilët kryejnë kësi lloj veprash, janë persona zyrtarë të cilët kanë autorizime të konsiderueshme prandaj edhe parashtruesit e kallëzimeve penale e edhe prokurorët gjatë hetuesisë shfaqin një lloj frike sepse siguria e prokurorëve nuk është e nivelit të duhur.

3.2. Gjykatat Komunale dhe të Qarkut të Kosovës 2008 dhe 2011

Përgjithësisht, shqyrtimi i veprave penale të korrupsionit nga gjykatat si të nivelit komunal dhe të qarkut ka qenë i karakterizuar me një ecje shumë të ulët dhe me dënime tërësisht të buta.

Në gjykatat komunale dhe të qarkut gjatë viteve 2008-2011 si raste të dyshuara kundër detyrës zyrtare (korrupsionit - Kapitulli XXIX - i KPK-së) në punë kanë qenë 1548, nga të cilat 460 (**29.7 %**), raste janë zgjidhur, ndërsa kanë mbetur pa u zgjidhur edhe 1088 raste të dyshuara për vepër penale kundër detyrës zyrtare. Nga gjithsej 460 raste sa janë zgjidhur nga gjykata në periudhën raportuese, 33 raste prej tyre iu përkasin gjyqtarëve të EULEX-it.

Ndërsa sa u përket rasteve të dyshuara për vepra penale kundër ekonomisë (Kapitulli XXII i KPK-së), nga gjithsej 4941 raste sa kanë qenë në punë gjatë vitit 2008-11, vetëm 1346 (**27.2 %**) prej tyre janë zgjidhur nga gjykata komunale dhe të qarkut, ndërsa kanë mbetur pa u zgjidhur edhe 3595 raste. Po ashtu, një trend i njëjtë i ka përcjellë edhe rastet e veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore (Kapitulli XXIV i KPK), ku nga 25709 raste sa kanë qenë në punë gjatë vitit 2008-11, vetëm 6546 (**25.4 %**) prej tyre janë zgjidhur nga gjykatat, ndërsa kanë mbetur pa u zgjidhur edhe 19163 raste. Struktura e këtyre të dhënave paraqiten në tabelën e më poshtme.

⁶ Intervistë me Prokuroren Drita Hajdari me 27-06-2012.




Tabela 5: Struktura në përqindje e trendit të shqyrtimi të veprave penale: a) Kapitulli XXIX - i KPK-së; b) Kapitulli XXII i KPK-së; c) Kapitulli XXIV i KPK, të Kodit Penal të Kosovës.

Kapitulli XXIX <u>Vepra Penale Kundër Detyrës Zyrtare</u>	VITI 2008	VITI 2009	VITI 2010	VITI 2011	TOTALI
Raste në punë	353	398	390	407	1548
Raste të zgjidhura	100	110	114	136	460
Raste të pazgjidhura	253	288	276	271	1088
Kapitulli XXII <u>Vepra Penale Kundër Ekonomisë</u>					
Raste në punë	1227	1323	1229	1162	4941
Raste të zgjidhura	283	391	328	344	1346
Raste të pazgjidhura	944	932	901	818	3595
Kapitulli XXIV <u>Veprat Penale Kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore</u>					
Raste në punë	5679	6044	6522	7464	25709

Raste të zgjidhura	1347	1631	1360	2208	6546
Raste të pazgjidhura	4332	4413	5162	5256	19163

Tabela 6: Struktura e trendit të rasteve në punë, të zgjidhura, dhe të pazgjidhura të kapitujve: a) Kapitulli XXIX - i KPK-së; b) Kapitulli XXII i KPK-së; c) Kapitulli XXIV i KPK, të Kodit Penal të Kosovës gjatë viteve 2008-2011të Gjykatave Komunale dhe të Qarkut.

Tabela më lart tregon se në gjykatat e Kosovës ekziston një trend shumë i ulët i shqyrtimit të rasteve që i takojnë kapitullit të XXIX të Kodit Penal të Kosovës, që quhen vepra penale kundër korrupsionit, por edhe të veprave tjera penale në përgjithësi.

Vendimet	2008	2009	2010	2011	TOTALI	Përqindja
Dënim me burgim	13	16	6	20	55	11.9 %
Dënim me gjobë	28	32	29	45	134	29.1 %
Dënim me kusht	16	22	24	25	87	18.9 %
Dënime tjera	1	4	2	1	8	1.7 %
Me aktgjykim lirues	6	6	5	8	25	5.4 %
Me aktgjykim refuzues	4	5	8	3	20	4.3 %
Është parashkruara	0		0	0	0	0 %
Është zgjidhur në mënyrë tjetër	32	25	40	34	131	28.4 %
Totali	100	110	114	136	460	100 %

Tabela 7: Natyra e vendimeve për rastet kundër korrupsionit të shqyrtuara nga gjykatat komunale dhe të qarkut për vitet 2008-2011.

Po të shihen vendimet gjyqësore të gjykatave komunale dhe të qarkut, lidhur me veprat penale kundër detyrës zyrtare, shihet se nga gjithsej **460 lëndë** që janë gjykuar për katër vite, vetëm **244 (61.6 %)** lëndë kanë përfunduar me dënime, ndërsa **176 (38.1 %)**, lëndë kanë përfunduar me aktgjykim lirues ose janë zgjidhur në mënyra tjera.

Nga **29.7 %** e totalit të lëndëve kundër korrupsionit, lëndëve që janë gjykuar nga gjykata komunale dhe të qarkut për vitet 2008-11, vetëm **18.3 %** e tyre kanë përfunduar me aktgjykime dënuese, nga të cilat, **8.6 %** kanë përfunduar me gjobë. Ndërsa **11.3 %** e lëndëve të gjykuara kanë përfunduar me aktgjykim lirues.

Po të analizohen të dhënat, del se gjykatat komunale dhe të qarkut kanë shqyrtuar një numër shumë të vogël të lëndëve kundër detyrës zyrtare që i kanë pasur në punë. Nga ky numër i vogël i lëndëve të shqyrtuara, kemi një numër të vogël të lëndëve të

përfunduara me aktgjykim dënues. Mirëpo, edhe nga ky numër shumë i vogël i lëndëve të përfunduara me aktgjykim dënues, sanksione e që kanë pasuar janë shume të dobëta të tilla si: **a)** dënime me gjoba ose; **b)** dënime me kusht. Kjo nënkupton se edhe pse kemi shumë pak vendime gjyqësore për vepra penale kundër detyrës zyrtare, gjithsej **284 vendime gjyqësore dënuese** në periudhën 2008-11, vetëm **55** vendime kanë qenë me burg, ndërsa **229** vendime kanë qenë dënime: **a)** me gjobë, **b)** kusht dhe **c)** dënime tjera.




Tabela 8: natyra e dënimeve për veprat penale kundër detyrës zyrtare (korrupsionit) të kapitullit XXIX, të Kodit Penal të Kosovës, gjatë viteve 2008-2011.

4. Përfundim

Nga analizimi i të dhënave të prokurorive publike dhe gjykatave mbi shqyrtimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare (korrupsionit) nga organet e drejtësisë, përgjatë viteve 2008-2011, pasqyrohet se organet e drejtësisë nuk kanë në prioritet luftën kundër korrupsionit.

Të dhënat e analizuara në këtë raport monitorues tregojnë për një trend shumë të ulët të shqyrtimit të lëndëve kundër korrupsionit. Për më shumë, raporti tregon po ashtu edhe numër shumë të ulët të lëndëve që kanë përfunduar me aktakuzë (tek prokuroritë) dhe atyre që kanë përfunduar me dënim me burg (tek gjykatat). Raporti, përmes statistikave të ofruara ka dëshmuar që lufta kundër korrupsionit nuk përbën prioritet për sistemin e drejtësisë, të shpallur aq shumë përmes dokumenteve të ndryshme strategjike. Përkundrazi, luftimi i korrupsionit mbetet ende në nivele rudimentare dhe me intensitet të ulët.

Në tërë historinë e funksionimit të tij, sistemi i drejtësisë ka treguar që nuk posedon integritet të duhur por edhe imunitetin e domosdoshëm për të zbatuar ligjin. Prokuroritë publike por edhe gjykatat edhe brenda domenit të tyre kanë zyrtarë të përfshirë në vepra penale. Po ashtu, të dhëna të mëhershme tregojnë që numër shumë i madh i lëndëve penale është parashkruar deri më tani, në mesin e të cilave edhe lëndë të korrupsionit.

Nuk ka dyshim që sistemi i drejtësisë në Kosovë ka qenë i ballafaquar me vështirësi të tilla si mungesa e stafit të specializuar dhe e numrit të domosdoshëm të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Për më shumë, mungesa e buxhetit të duhur në mënyrë të vazhdueshme ka penguar funksionimin normal të sistemit të drejtësisë.

Megjithëkëtë, niveli i ulët i shqyrtimit të lëndëve të korrupsionit, por edhe i veprave të tjera penale si dhe dënimet shumë të buta për kryerësit e këtyre veprave, dëshmojmë qartazi se sistemi i drejtësisë ka dështuar në vendosjen e një standardit të fuqishëm të sundimit të ligjit në Kosovë.